

Njoftim mbi shqyrtimin e çmimeve të ngrohjeve qendrore

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë njofton se ka për qëllim që më 11 qershor 2007 të fillojë shqyrtimin e çmimeve për ndërmarrjet e Ngrrohjeve Qendrore për sezonin e ngrohjes 2007/2008.

Shqyrtimi i çmimeve do të kryhet duke u bazuar në kompetencat që i jepen ZRRE-së nga Ligji i Rregullatorit të Energjisë, dhe në përputhje me Udhëzimin mbi Raportimin Rregullativ dhe Udhëzimet mbi Parimet për Kalkulimin e Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrrohjes Qendrore. Shqyrtimi i çmimeve do të zhvillohet sipas planit implementues dhe orarit. Udhëzimet, plani implementues & orari, dhe dokumentet tjera të nevojshme gjenden në faqen elektronike të ZRRE-së: www.ero-ks.org.

ZRRE-ja i fton të gjitha palët me interes në këtë shqyrtim që të regjistrohen me ZRRE-në, ose përmes emailit në ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org, ose përmes faksit, apo përmes letrës të shënjuar për vëmendjen e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve apo Ekspertit të Ngrrohjes Qendrore. Palët e regjistruara do të lajmërohen kur dokumentet e nevojshme janë lëshuar nga ZRRE-ja.

Propozimet do të pranohen, apo mundësitë për pjesëmarrje publike do të shfaqen gjatë rrjedhës së shqyrtimit të çmimeve.

Regjistrimi do të përfundojë me 4 korrik 2007. Lista e palëve të regjistruara dhe adresat kontaktuese do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE-së.

Palët e regjistruara kanë mundësinë për pjesëmarrje publike duke dërguar propozime me shkrim apo komente mbi dokumentet e nevojshme të publikuara apo çështje tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin e çmimit të ngrohjeve qendrore. Çdo palë që dëshiron të bëjë propozime ftohet që t'i dërgojë këto ZRRE-së, ose përmes emailit në ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org, apo përmes faksit, apo me letër të shënjuar për vëmendjen e Departamentit të tarifave & Çmimeve dhe /apo Ekspertit për Ngrrohje Qendrore.